



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 329/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.05.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Vale Recycling” shpk në procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*”, me nr. REF- 10579-02-26-2019, me objekt “*Trajtimi dhe evadimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore , në spitalin Pogradec*”- *Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat (12 muaj) sasia e mbetjeve 8000 kg*”, me fond limit 3.833.333 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 01.04.2019, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Sherbimit Spitalor Pogradec.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Pura Medical” nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

“Medi Tel” shpk
Autostrada TR-DR, Km.1 Rruga “Vidhe Gjata”, Nr.18
Tiranë

“Pura Medical” shpk
Ish Reparti i Kipit të Furnaltës, Kombinati Metalurgjik
Elbasan

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Sherbimit Spitalor Pogradec,
Rr. "Islam Dani", Lagjia Nr. 5 Pogradec

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*", i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "*Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjeve, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar;

I.4. Operatorët ekonomikë kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesave pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesave.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 26.02.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*”, me nr. REF- 10579-02-26-2019, me objekt “*Trajtimi dhe evadimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore , në spitalin Pogradec*”- *Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat (12 muaj) sasia e mbetjeve 8000 kg*”, me fond limit 3.833.333 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 01.04.2019, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Sherbimit Spitalor Pogradec.

II.2. Në datën 01.04.2019 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 05.04.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezulton si më poshtë vijon:

- Eco Riciklim	480,00	I skualifikuar
- Pura Medical	2,500,000	I skualifikuar
- Vale Recycling	3,523,200	I kualifikuar
- Medi Tel	3,760,000	I kualifikuar

II.4. Në datën 08.04.2019 operatori ekonomik “Medi Tel” shpk ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për kualifikimin e ofertës së së operatorit ekonomik “Vale Recycling” shpk në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Në rastin konkret Vale Recycling ka dështuar të paraqesë dokumentacionet që vërtetojnë përmbushjen e kriterëve të mësipërme. Përandaj ky OE nuk duhej kualifikuar nga AK. Specifikisht Vale recycling ka paraqitur: Mostrat e kontenitorëve të shoqërisë Apmedical (sot keter Italia spa). Ju bëjmë me dije se distributori i vetëm i autorizuar i Apmedical (sot Keter Italia spa) që të paraqesë apo për më tepër të përdorë kontenitorët e kësaj shoqërie në tenderin me objekt prokurimi. Për të vërtetuar këtë ju lutem gjeni bashkëngjitur autorizimin zyrtar).*
- *Në djetinë tonë OE Vale Recycling nuk disponon një kontratë për depozitimin përfundimtar të materialit që del pas autoklavimit në asnjë landfill të licensuar kriter ky i kërkuar në DST nga AK.*
- *Kjo mënyrë vlerësimi e kapaciteteve dhe dokumentacionit të paraqitur ose jo nga Vale Recycling është i paligjshëm pasi në nenin 53 të LPP përcaktohet se vlerësimi i ofertave bëhet vetëm në baza teknike dhe ekonomike. Ndërkohë që AK nuk ka vlerësuar anën teknike të ofertës ku po të verifikohet do të shihet se vale recycling nuk zotëron*

dokumentacionin e nevojshëm. Mosgjykimi i mangësive teknike dhe faktit të mosparaqitjes së disa dokumentave shkel nenin 53 të LPP. Kjo formë tolerante e gjykimit mbi mosplotësimin e kriterëve dhe të dokumentacionit apo mungesës së tij mbi Vale Recycling shkel nenin 1 dhe 2 të LPP. Këkrojmë shpalljen fitues të operatorit ekonomik Medi Tel shpk.

II.5. Në datën 11.04.2019 me shkresën nr.29 prot autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues ku ka vendosur mospranimin e ankesës.

II.6. Në datën 18.04.2019, pala ankimuese “Medi Tel” shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Në datën 05.04.2019 operatori ekonomik “Pura Medical” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- *Kriteret e skualifikimit per proceduren e prokurimit me objekt: “Trajtimi dhe evadimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore , në spitalin Pogradec”- Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat (12 muaj) ”. Fondi limit: 3.833.333 (Tremilioneteteqindetridhjetetremijetreqindetridhjetet) leke pa tvsh ose 4.600.000 (Katermilioneqjashteqindmije) leke me tvsh*
- *Operatori ekonomik ‘Pura Medical shpk “ me nipt L71515507M nuk permbush Dokumentat Standarte te Tenderit shtojca 8”specifikimet teknike” → Ne te cilen citohet : “Operatoret ekonomike qe do te marrin pjese ne konkurim duhet te sjellin me pare , prane KVO para hapjes se procedures se Prokurimit , mostrat e kontenjereve plastike dhe te kutive te kartonit me qeset e plastmasit sipas kerkesave standarteve per trajtimin e mbetjeve te rrezikshme spitalore , te percaktuara ne VKM nr 798 date 29.09.2010 si dhe ne Udhezuesin Kombetar te " Administrimit te sigurt te mbetjeve spitalore “. Realisht subjekti “Pura Medical shpk ” nuk ka paraqitur prane KVO –se me procesverbal te nenshkruar ndermjet te dy paleve mostrat e sipercituara para hapjes se procedures se Prokurimit. →*
- *Ne “Kriteret e Vecanta te Kualifikimit “ pika 2.3 ”Kapaciteti teknik nenpika 3 citohet se operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje: Operatoret ekonomik pjesmarres duhet te dokumentojnë se kanë në pronësi impiant, i cili të jetë i licensuar nga Ministria e Mjedisit për kryerjen e këtij shërbimi sipas Objektit teprokurimit si dhe te jete i pajisur me akt-miratimi higjeno-sanitar per ushtrimin e veprimtarise leshuar nga Inspektorati Sanitar Shteteror (ISSH). Realisht subjekti “Pura Medical shpk” nuk ka paraqitur dokumentacionin ligjor qe te vertetoje pronesine e impiantit si dhe aktin e miratimit higjeno sanitar perkates.*

II.8. Në datën 11.04.2019 operatori ekonomik “Pura Medical” shpk ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- Në orën 9 të mëngjesit të datës 01.04.2019 menaxheri i firmës Pura Medical shpk ka telefonuar nëndrejtorin e spitalit Pogradec me nr. Tel 0694829533 dhe i ka komunikuar që brenda orarit të hapjes së ofertave, një përfaqësues i Pura medical shpk do të sillte mostrat e kërkuara sipas DT. Në orën 9 e 45 zonja Evis Naco dentiste në qytetin e pogradecit me autorizim nga administratori i firmës Pura Medical shpk pra minimalisht 15 min përpara afatit të dorëzimit të ofertave është paraqitur pranë sekretarisë së spitalit dhe pasi e ka sqaruar që mostrat ishin për procedurën në fjalë sekretaria e ka sqaruar që dorëzimi i mostrave do të bëhej në cast dhe për këto raste praktika e punës ishte që për këto lloj dorëzimesh nuk mbahej procesverbal. Që ne disponojmë këtë kapacitet teknik të konteniervë sipas standarteve të VKM 798 dhe të dorëzimit të një palë mostrash përpara hapjes së ofertave e vërtetojmë jo vetëm me certifikatat e konteniervë që kemi dorëzuar në sistem nga prodhuesi italian i konteniervë tanë por edhe nga një foto e depozituar në sistem të app në procedurën në fjalë , të mostrave konkrete që janë dorëzuar pranë Spitalit të Pogradecit. Vëmë në dijeni se refuzimi juaj është bërë për shkak se dorëzimi i këtyre mostrave është bërë pa procesverbal të firmosur nga të dyja palët. Por së pari kjo arsye nuk është e përligjur për shkak se në DT nuk ka pasur asnjë kërkesë për ekzistencën e një procesverbali të tillë si dhe nëse do të ishte një kërkesë e tillë detyrimin për mbajtjen e një procesverbali të tillë në këto raste e ka organi administrativ dhe jo operatori ekonomik ndaj në cdo rast detyrimin për mbajtjen e një procesverbali të tillë e kishit ju dhe jo Pura Medical shpk. Që bara e provës në një gjykim administrativ i takon autoritetit administrativ, përcaktohet edhe nga ligji për gjykimin e çështjeve administrative. Pura Medical shpk është penalizuar në këtë rast për një detyrim që nuk e ka pasur. Detyrimi i saj i vetëm ishte të dorëzonte një palë mostra të konteniervë përpara hapjes së ofertave, detyrim që Pura Medical shpk e ka përmbushur në këtë rast. Kërkojmë që kjo të jetë edhe pjesë e një hetimi administrativ nga ana e AK.
- Lidhur me arsyen e dytë të skualifikimit sqarojmë se: kërkesa e dokumentave të tenderit është që “Mbetjet spitalore të përpunohen nga një impiant i licensuar nga ministria e mjedisit dhe në pronësi të operatorit” leja mjedisore pn 7777 12 2018 së bashku me akt miratimin e saj është një dokument ligjor i prodhuar nga MM që vërteton se Pura Medical shpk ka në pronësi një impiant të liecnsuar nga kjo ministri për përpunimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore (sipas kodeve në leje) të përbërë nga një ambient me një sipërfaqe rreth 800 m2 (sipas planimetrive të lejes) dhe katër aparatura përpunimi të mbetjeve spitalore në pronësi të Pura Medical shpk një incenerator , një autoklavë, një dhomë frigoriferike dhe një girës (sipas skicave të lejes) faqet 49,50,51 të aktmiratimit të lejes. Ky impiant është i pajisur edhe me leje higjenosanitare të dërguara në sistemin e app për procedurën në fjalë me nr.serie 000882.
- Sa i përket plotësimit të kushteve dhe kualifikimit të operatorëve Vale Recycling dhe Medi tel sqarojmë se: në shtojcën e dokumentave të tenderit kërkohet edhe kontratë me

një landfill të licensuar për depozitimin e mbetjeve spitalore të gjenruara nga ky autoritet pas përpunimit të tyre. Ju vëmë në dijeni që i vetmi landfill i licencuar që kryen depozitimin e të gjithë produktit që del nga përpunimi i mbetjeve spitalore është landfilli i elbasanit i njohur ndryshe me emrin Albtek Energy përfshi edhe materialet e pabiodegradueshme si hiret, që dalin nga djegja e mbetjeve me kod 18 01 02 që janë mbetjet që do të përpunohen nga kjo procedurë. Këtë qëndrim ka mbajtur edhe Inspektoriati Shtetëror Mjedisor në raste të ngjashme. Ju vëmë në dijeni se Vale Recycling dhe Medi Tel nuk kanë një kontratë me këtë landfill dhe smund të depozitojnë produktin që del nga djegja e hireve në këtë rast. Kjo mangësi do të duhej të ishte kapur vëtë nga AK sa kohë që në shtojcën e DT kërkohej dhe një aktmiratim i lejes dhe licencës së landfillit ku operatori do të depozitonte produktin pas përpunimit të mbetjeve spitalore. Dhe në këto leje dhe licenca del shumë qartë se cili landfill mund të depozitojë të gjithë produktet që dalin nga mbetjet spitalore dhe kush jo. Për të gjitha këto arsyse kërkojmë kualifikimin e Pura Medical shpk dhe skualifikimin e OE Vale recycling dhe Medi Tel shpk.

II.9. Në datën 16.04.2019 me shkresën nr.31 prot autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues ku ka vendosur mospranimin e ankesës.

II.10. Në datën 24.04.2019 pala ankimuese “Pura Medical” shpk., ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.11. Nëpërmjet shkresës nr.207 prot datë 03.05.2019 protokolluar me tonën me nr.746/2 prot datë 06.05.2019 dhe shkresës me nr.208 prot datë 03.05.2019 protokolluar me tonën me nr.721/2 datë 06.05.2019 autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Pura Medical” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “Operatori ekonomik ‘Pura Medical shpk “ me nipt L71515507M nuk permbush Dokumentat Standarte te Tenderit shtojca 8”specifikimet teknike” – Ne te cilen citohet : “Operatoret ekonomike qe do te marrin pjese ne konkurim duhet te sjellin me pare , prane KVO para hapjes se procedures se Prokurimit , mostrat e kontenjereve plastike dhe te kutive te kartonit me qeset e plastmasit sipas kerkesave standarteve per trajtimin e mbetjeve te rrezikshme spitalore , te percaktuara ne VKM nr 798 date 29.09.2010 si dhe ne Udhëzuesin Kombetar te " Administrimit te sigurt te mbetjeve

spitalore “. Realisht subjekti “Pura Medical shpk ” nuk ka paraqitur prane KVO –se me procesverbal te nenshkruar ndermjet te dy paleve mostrat e sipercituara para hapjes se procedures se Prokurimit”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8 “Specifikimet Teknike” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

- *Operatoret ekonomike qe do te marrin pjese ne konkurim duhet te sjellin me pare , prane KVO para hapjes se procedures se Prokurimit , mostrat e kontenjereve plastike dhe te kutive te kartonit me qeset e plastmasit sipas kerkesave standarteve per trajtimin e mbetjeve te rrezikshme spitalore , te percaktuara ne VKM nr 798 date 29.09.2010 si dhe ne Udhezuesin Kombetar te " Administrimit te sigurt te mbetjeve spitalore “.*

III.1.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor depozituar pranë KPP me shkresën prot me tonën nr.746/2 datë 06.05.2019, rezulton se janë mbajtur procesverbalet me nr.02/14 prot datë 05.03.2019 për marrjen në dorëzim nga ana e KVO të mostrave të operatorit ekonomik “Medi Tel” shpk dhe procesverbali me nr.02/15 prot datë 05.0.2019 për marrjen në dorëzim nga ana e KVO të mostrave të operatorit ekonomik “Vale Recycling” shpk. Nuk rezulton një procesverbal i njëjtë i mbajtur për mostrat e paraqitura nga operatori ekonomik “Pura Medical” shpk.

Referuar pretendimeve në ankesë edhe vetë ankimuesi pranon se nuk ka dokumentuar paraqitjen e mostrave pranë KVO por pretendon se ato janë dorëzuar në sekretari pa mbajtjen e një procesverbali. KPP gjykon se në rastin konkret operatori ekonomik “Pura Medical” nuk provon se ka dorëzuar mostrat pranë KVO-së për verifikim. KPP gjykon se ankimuesi duhet të ishte treguar i kujdesshëm për përmbushjen e kësaj kërkesë dhe të kishte kërkuar dokumentimin e dorëzimit të mostrave nwse i ka dorëzuar ato, sikundër është vepruar për dy operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurë. Mungesa e një dokumenti të tillë con në pamundësinë për të provuar faktin e dorëzimit të mostrave nga ana e operatorit ekonomik ankimues në kushtet kur edhe vetë informacioni i depozituar nga autoriteti kontraktor nuk përmban procesverbalin e dorëzimit të mostrave edhe për operatorin Pura Medical shpk sikundër për operatorët e tjerë. KPP gjykon se operatori ekonomik Pura Medical shpk nuk përmbush kërkesën e parashikuar në specifikimet teknike për dorëzimin e mostrave pranë KVO-së e rrjedhimisht skualifikimi i tij është i drejtë.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në

përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në respekt të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar.

KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik "Pura Medical" shpk nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues "Pura Medical" shpk mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron dhe OE nuk përmbush specifikimet teknike dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P do të mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik "Pura Medical" shpk mbi skualifikimin e operatorëve ekonomikë "Medi Tel" shpk dhe "Vale Recycling" shpk KPP sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (i ndryshuar), me titull "Të drejtat e personit të interesuar" ku parashikohet se: *"Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin."* Neni 63, pika 1 kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Sa më sipër pretendimet nuk merren në shqyrtim.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Medi Tel" shpk për skualifikimin e operatorit ekonomik "Vale Recycling" shpk me arsyetimin se *"Në rastin konkret Vale Recycling ka dështuar të paraqesë dokumentacionet që vërtetojnë përmbushjen e kriterëve të mësipërme. Përandaj ky OE nuk duhej kualifikuar nga AK. Specifikisht Vale Recycling ka paraqitur:*

Mostrat e kontenitorëve të shoqërisë Apmedical (sot keter Italia spa). Ju bëjmë me dije se distributori i vetëm i autorizuar i Apmedical (sot Keter Italia spa) që të paraqesë apo për më tepër të përdorë kontenitorët e kësaj shoqërie në tenderin me objekt prokurimi. Për të vërtetuar këtë ju lutem gjeni bashkëngjitur autorizimin zyrtar”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. . Në shtojcën 8 “Specifikimet Teknike” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

- *Operatorët ekonomike që do të marrin pjesë në konkurim duhet të sjellin me pare , pranë KVO para hapjes së procedurës së Prokurimit , mostrat e kontenjereve plastike dhe te kutive te kartonit me qeset e plastmasit sipas kerkesave standarteve per trajtimin e mbetjeve te rrezikshme spitalore , te percaktuara ne VKM nr 798 date 29.09.2010 si dhe ne Udhezuesin Kombetar te " Administrimit te sigurt te mbetjeve spitalore “.*

III.4.2. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”*

III.4.3. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.*

III.4.4. Referuar informacionit të autoriteteit kontraktor depozituar pranë KPP me shkresën prot me tonën nr.746/2 datë 06.05.2019, rezulton se janë mbajtur procesverbalet me nr.02/14 prot datë 05.03.2019 për marrjen në dorëzim nga ana e KVO të mostrave të operatorit ekonomik Medi Tel shpk dhe procesverbali me nr.02/15 prot datë 05.0.2019 për marrjen në dorëzim nga ana e KVO të mostrave të operatorit ekonomik “Vale Recycling” shpk. Në këtë kuptim provohet fakti i dorëzimit të mostrave nga ana e operatorit ekonomik Vale Recycling shpk në procedurën e prokurimit objekt ankimi në përputhje me specifikimet teknike.

Nga shqyrtimi i kriteve të tjera kualifikuese në dokumentata e procedurës së prokurimit objekt ankimi nuk rezulton që autoriteti kontraktor të ketë kërkuar një dokument autorizim prodhuesi të konteniervë apo autorizim distributori apo ndonjë dokument tjetër shoqërues në momentin e dorëzimit të mostrave apo në fazën e dorëzimit të ofertave. Në këto kushte operatorët ekonomikë nuk kanë pasur detyrimin për të dorëzuar një dokument të tillë. Në shtojcën 8 specifikimet teknike janë kërkuar vetëm paraqitja e mostrave (konteniervë) pa ndonjë dokumentacion shoqërues. KPP gjykon se autoriteti kontraktor në vlerësimin e ofertave nuk mund të përdorë

asnjë kriter apo specifikim tjetër i cili nuk është i përfshirë në dokumentat e tenderit kjo në kuptim të nenit 55 “Kriteret e Përcaktimit të Ofertës Fituese” pika 2 e LPP i cili parashikon shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.*

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik “Medi Tel” shpk nuk qëndrojnë.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Medi Tel” shpk për skualifikimin e operatorit ekonomik “Vale Recycling” shpk me arsyetimin se “*Në djetinë tonë OE Vale Recycling*” shpk nuk disponon një kontratë për depozitimin përfundimtar të materialit që del pas autoklavimit në asnjë landfill të licensuar kriter ky i kërkuar në DST nga AK”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.5.1. Në shtojcën “modifikim mbi dokumentat e tenderit” të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- *Në “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pikes 2.3 “Per kapacitetin teknik” i shtohet nenpika 8 me kete permbatje:*

Per te permbushur deri ne fund procesin e prodhimit, grumbullimit, ndarjes, transportit, magazinimit, përpunimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore të gjithë operatorët ekonomik pjesmarres duhet të paraqesin ne kete procedure prokurimi dokumentacionin ligjor original ose të noterizuar (leje, kontrate, marrveshje) për depozitimin e produktit final që del nga përpunimi i mbetjeve spitalore. Produkti final që del nga përpunimi i mbetjeve spitalore të depozitohet ne landfill të licensuar nga organet kompetente shtetore. Per kete arsye duhet të paraqitet orgjinale ose e noterizuar lincensa e landfillit ku do të behet depozitimi i produktit final që del nga përpunimi i mbetjeve spitalore.

III.5.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se në përmbushje të kriterit sa më sipër operatori ekonomik “Vale Recycling” shpk ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë Shërbimi datë 18.04.2017 lidhur ndërmjet shoqëria Ndërkomunale Bushat sha në cilësinë e porositësit dhe shoqëria Becker Albania sha në cilësinë e operatorit me objekt: *Objekti i kësaj kontrate është përcaktimi i kushteve midis palëve për dhënien në përdorim të landfillit të bushatit, operatorit dhe realizimit prej tij të shërbimeve të depozitimit, administrimit, menaxhimit, përpunimit dhe riciklimit të mbetjeve të ngurta urbane në landfillin e bushatit. Shërbimet e depozitimit, administrimit, menaxhimit përpunimit dhe riciklimit të mbetjeve të ngurta urbane në landfillin e bushatit merren përsipër të kryhen prej operatorit në përmbushje të kushteve të kësaj kontrate.*
- *Leje Mjedisore Kodi III.1.B për aktivitetin e funksionimit të venddepozitimit të mbetjeve urbane në emër të Becker Albania. Akt Miratimi Leje Mjedisore Nr.7185/4 datë 15.12.2010*

- *Kontratë Nr.55 prot datë 21.03.2019 lidhur ndërmjet Ndërkomunale Bushat sha dhe Vale Recycling shpk . Shoqëria dhe Klienti dëshirojnë të hyjnë në një marrëdhënie kontraktuale në të cilën shoqëria pranon të depozitohen beturinat urbane të pranueshme në landfill nga ose në emër të klientit dhe klienti do të lëvrojë një sasi kontraktuale të mbeturinave urbane të pranueshme dhe do të paguajë shoqërinë për depozitim e këtyre mbeturinave.*

III.5.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”*

III.5.4. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.*

III.5.5. Nga shqyrtimi i dokumnetacionit të sipërituar, KPP gjykon se operatori ekonomik “Vale Recycling” shpk ka dorëzuar në përputhje me kriterin kualifikues dokumentacion lidhur me një landfill të licensuar nga organet kompetente shtetërore, për depozitim e produktit final që del nga përpunimi i mbetjeve spitalore. KPP gjykon se operatori ekonomik ka përmbushur kërkesat në kriterin e vecantë të kualifikimit duke dëshmuar se disponon një landfill në një nga format e lejuara ligjore për depozitim e produktit final.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Medi Tel “shpk nuk qëndron

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Pura Medical” shpk për procedurën e prokurimit, “Kërkesë për Propozime”, me nr. REF- 10579-02-26-2019, me objekt “Trajtimi dhe evadimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore , në spitalin Pogradec”- Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat (12 muaj) sasia e mbetjeve 8000 kg”, me fond limit 3.833.333 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 01.04.2019, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Sherbimit Spitalor Pogradec.
2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Medi Tel” shpk në procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 721 Protokolli; Datë 18.04.2019

Nr.746 Protokolli; Datë 24.04.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha

